



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.95

17 korrik

2011

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.445, datë 16.6.2011	Për një ndryshim në vendimin nr.437, datë 8.4.2008 të Këshillit të Ministrave “Për anëtarësimin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë në deklaratën “Dekada e romëve””....	3883
Vendim i KM nr.446, datë 22.6.2011	Për pjesëmarrjen dhe lejimin e ekspozimit të disa dokumenteve origjinale në ekspozitën “Shkëlqimi i Bizantit, dorëshkrime bizantine të dekoruara në Ballkan, shek. VI-XII”.....	3883
Vendim i KM nr.447, datë 22.6.2011	Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Fondi i investimeve sociale, faza IV”.....	3884
Vendim i KM nr.448, datë 22.6.2011	Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Programi i mbrojtjes së mjedisit të liqenit të Ohrit – shkarkimi i ujërave të zeza në Pogradec, faza III”.....	3886
Vendim i KM nr.449, datë 22.6.2011	Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar, 2009, për projektin “Programi i infrastrukturës komunale I”	3888
Vendim i KM nr.450, datë 22.6.2011	Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar, 2008, 2010, për projektin “Infrastruktura komunale II”	3890

Vendim i KM nr.451, datë 22.6.2011	Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2008, për projektin “Masterplani në sektorin ujor”	3892
Vendim i KM nr.454, datë 22.6.2011	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Paskuqan të qarkut të Tiranës	3893
Vendim i KM nr.456, datë 22.6.2011	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Cakran të qarkut të Fierit	3894
Vendim i KM nr.457, datë 22.6.2011	Për miratimin e dëshmperblimit financiar për ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist	3895
Vendim i KM nr.458, datë 22.6.2011	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të pronës nr.276 “Cirku i Tiranës” në juridiksion të Bashkisë së Tiranës	3901
Udhëzim i MF, MPPT dhe METE nr.14, datë 16.6.2011	Për pagesën e detyrimeve ndaj të tretëve të ndërmarrjeve dhe sha-ve në pronësi të pushtetit vendor	3901

VENDIM
Nr.445, datë 16.6.2011

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.437, DATË 8.4.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR ANËTARËSIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË DEKLARATËN “DEKADA E ROMËVE””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 4 e vendimit nr.437, datë 8.4.2008 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Kontributi fillestar prej 20 000 (njëzet mijë) eurosh, që është vetëm për anëtarësimin në këtë nismë, si edhe shumat e kontributit për secilin vit pasues, që do të vendosen nga Komiteti Drejtues i “Dekadës së përfshirjes së romëve”, për vitin 2012 e në vijim, të përballohen nga fondet e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.”.

2. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2012.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.446, datë 22.6.2011

**PËR PJESËMARRJEN DHE LEJIMIN E EKSPOZIMIT TË DISA DOKUMENTEVE
ORIGJINALE NË EKSPOZITËN “SHKËLQIMI I BIZANTIT, DORËSHKRIME BIZANTINE TË
DEKORUARA NË BALLKAN, SHEK.VI-XII”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 83 të ligjit nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të marrë pjesë dhe të ekspozojë dokumentet origjinale, në ekspozitën “Shkëlqimi i Bizantit. Dorëshkrime bizantine të dekoruara në Ballkan, shek.VI-XII”, që hapet në Galerinë Kombëtare të Arteve në Sofje, Bullgari, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Dokumentet do të qëndrojnë të ekspozuara nga data 22 gusht 2011 deri në datën 25 shtator 2011 dhe rikthimi i tyre në vendruajtjen e përhershme do të bëhet në datën 2 tetor 2011.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të nënshkruajë marrëveshjen përkatëse me organizatorët e ekspozitës, për kërkesat dhe kushtet e sigurimit në udhëtim, si dhe për kohën e veprimtarisë.

4. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E DOKUMENTEVE ORIGJINALE QË DO TË EKSPOZOHEN NË EKSPOZITËN
“SHKËLQIMI I BIZANTIT. DORËSHKRIME BIZANTINE TË DEKORUARA NË BALLKAN,
SHEK. VI-XIII”

1. Kodiku u purpurt i Beratit nr.1, dyngjillësh, shek.VI (f.488, D1): faqet 112,113,114,115;
2. Kodiku i Beratit nr.2, katërungjillësh, shek.IX (f.488, D 2): faqet 254, 255, 414, 415, 656,
657;
3. Kodiku i Beratit nr.3, ungjillar, shek. IX (f. 488, D 3) i plotë;
4. Kodiku i Beratit nr.4, katërungjillësh, shek.X (f.488 D.4) i plotë;
5. Kodiku i Vlorës nr.5, katërungjillësh, shek.X (f.488, D.5) i plotë;
6. Kodiku i Vlorës nr.10, katërungjillësh, shek.XIV (f.488, D.10) i plotë;
7. Kodiku i Vlorës nr.11, ungjillar, shek.XIII (f.488, D.11) i plotë;
8. Kodiku i Vlorës nr.13, ungjillar, shek.XIII-XIV (f.488, D.13) i plotë;
9. Kodiku i Beratit nr.15, katërungjillësh, shek.X (f.488, D.15) i plotë;
10. Kodiku i Beratit, nr.17, Veprat e apostujve, shek.X (f.483, D.17), i plotë;
11. Kodiku i Beratit nr.25, Panegjeric, shek.IX (f.488, D.25), i plotë;
12. Kodiku i Beratit nr.27, ligjërata të Vasilit të Madh, shek.IX-X (f.488, D.27) i plotë;
13. Kodiku i Korçës, nr.92, katërungjillësh, shek.X (f.488, D.92), i plotë;
14. Kodiku i Korçës nr.93, katërungjillësh, shek.X (f.488, D.93) i plotë.

VENDIM
Nr.447, datë 22.6.2011

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË
GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR 2010, PËR PROJEKTIN
“FONDI I INVESTIMEVE SOCIALE, FAZA IV”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998
“Për lidhjen traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozim të Zëvendëskryeministrit dhe
Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe
Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Fondi
i investimeve sociale, faza IV”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR 2010 PËR PROJEKTIN “FONDI SOCIAL I INVESTIMEVE IV”

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë:

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë;

të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje;

me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë;

duke iu referuar protokollit të bisedimeve ndërqeveritare të datës 18 maj 2010.

u morën vesh si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose një huamarrësi tjetër, i cili do të zgjidhet bashkërisht nga të dyja qeveritë, të marrë për projektin “Fondi social i investimeve IV” një hua me kushte të favorshme nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW), e cila akordohet në kuadër të bashkëpunimit publik zhvillimor, me vleftë prej deri në 20 000 000 euro (me fjalë: njëzet milionë euro), kur nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t'u mbështetur në kuadër të politikës zhvillimore dhe kur Republika e Shqipërisë vazhdon të jetë e besueshme lidhur me kreditë dhe kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë jep garanci shtetërore, në rast se ai vetë nuk është huamarrës. Projekti në fjalë nuk mund të zëvendësohet me projekte të tjera.

2. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau hua ose shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose shuma të tjera financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, atëherë gjen zbatim kjo marrëveshje.

3. Shumat e financimit për masa përgatitore dhe shoqëruese sipas paragrafit 2 do të kthehen në hua, në rast se ato nuk përdoren për masa të tilla.

Neni 2

1. Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të përfundohen midis Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe marrësve të huave dhe të shumave të financimit, të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

2. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1 paragrafi 1 do të zhvleftësohet, në rast se kontratat përkatëse të huadhënies nuk përfundohen brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premtimit. Për shumën në fjalë, ky afat mbaron në datën 31 dhjetor 2018.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është huamarrës, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau të gjitha pagesat në euro për shlyerjen e borxheve të huamarrësve në bazë të kontratave, të cilat do të përfundohen sipas paragrafit 1.

4. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është marrësi i shumave të financimit, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau pretendimet eventuale lidhur me shlyerjen, që mund të lindin në bazë të kontratave për financim, të cilat do të përfundohen sipas paragrafit 1.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e liron Kreditanstalt für Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratave të përmendura në nenin 2 paragrafi 1.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore që rezultojnë nga dhënia e huave dhe e shumave të financimit, nuk merr asnjë masë, e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe nxjerr në rastet e duhura lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë më 25.5.2011 në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur të dyja tekstet fuqi të barabartë.

VENDIM

Nr.448, datë 22.6.2011

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR 2010, PËR PROJEKTIN “PROGRAMI I MBROJTJES SË MJEDISIT TË LIQENIT TË OHRIT – SHKARKIMI I UJËRAVE TË ZEZA NË POGRADEC, FAZA III”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Programi i mbrojtjes së mjedisit të liqenit të Ohrit - shkarkimi i ujërave të zeza në Pogradec, faza III”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR 2010 PËR PROJEKTIN “PROGRAMI I MBROJTJES SË MJEDISIT TË LIQENIT TË OHRIT - SHKARKIMI I UJËRAVE TË ZEZA NË POGRADEC, FAZA E TRETË”

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë,

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë,

të ndërgjegjshëm se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje, me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë, duke iu referuar protokollit të bisedimeve ndërqeveritare të datës 18 maj 2010,

u morën vesh si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose një huamarrësi tjetër, i cili do të zgjidhet bashkërisht nga të dyja qeveritë, të marrë për projektin “Programi i mbrojtjes së mjedisit të liqenit të Ohrit - shkarkimi i ujërave të zeza në Pogradec, faza e tretë” një hua të kombinuar nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW), e cila akordohet në kuadër të bashkëpunimit publik zhvillimor, me vlerë deri në 10 000 000 euro (me fjalë: dhjetë milionë euro), kur nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t'u mbështetur në kuadër të politikës zhvillimore dhe kur Republika e Shqipërisë vazhdon të jetë e besueshme lidhur me kreditë dhe kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë jep garanci shtetërore, në rast se ai vetë nuk është huamarrës. Projekti në fjalë nuk mund të zëvendësohet me projekte të tjera.

2. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau hua ose shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose shuma të tjera financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, atëherë gjen zbatim kjo marrëveshje.

3. Shumat e financimit për masa përgatitore dhe shoqëruese sipas paragrafit 2 do të kthehen në hua, në rast se ato nuk përdoren për masa të tilla.

Neni 2

1. Përdorimi i shumave të përmendura në nenin 1, kushtet me të cilat vihen në dispozicion ato, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të përfundohen midis Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe marrësve të huave dhe të shumave të financimit, të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

2. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1 paragrafi 1 do të zhvleftësohet, në rast se kontratat përkatëse të huadhënies nuk përfundohen brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premtimit. Për shumën në fjalë, ky afat mbaron në datën 31 dhjetor 2018.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është huamarrës, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau të gjitha pagesat në euro për shlyerjen e borxheve të huamarrësve në bazë të kontratave, të cilat do të përfundohen sipas paragrafit 1.

4. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është marrësi i shumave të financimit, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau pretendimet eventuale lidhur me shlyerjen, që mund të lindin në bazë të kontratave për financim, të cilat do të përfundohen sipas paragrafit 1.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e liron Kreditanstalt für Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratave të përmendura në nenin 2 paragrafi 1.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore, që rezultojnë nga dhënia e huave dhe e shumave të financimit, nuk merr asnjë masë, e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë dhe nxjerr në rastet e duhura lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, më 27.4.2011, në dy origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur të dyja tekstet fuqi të barabartë.

VENDIM

Nr.449, datë 22.6.2011

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR, 2009, PËR PROJEKTIN “PROGRAMI I INFRASTRUKTURËS KOMUNALE I”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2009, për projektin “Programi i infrastrukturës komunale I”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR 2009 PËR PROJEKTIN “PROGRAMI I INFRASTRUKTURËS KOMUNALE I”

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë,

në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë:

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë,

të ndërgjegjshëm se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje, *me qëllim* për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë, *duke iu referuar* premtimit të Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë me anë të notës verbale nr.125/09 të datës 25 shtator 2009,

u morën vesh si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose një huamarrësi tjetër, i cili do të zgjidhet bashkërisht nga të dyja qeveritë, të marrë për projektin “Programi i infrastrukturës komunale I” një hua me kushte të favorshme nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW), e cila akordohet në kuadër të bashkëpunimit publik zhvillimor, me vleftë prej deri në 16 000 000 euro (me fjalë: gjashtëmbëdhjetë milionë euro), kur nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projektet vlejné për t’u mbështetur në kuadër të politikës zhvillimore dhe kur Republika e Shqipërisë vazhdon të jetë e besueshme lidhur me kreditë dhe kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë jep garanci shtetërore, në rast se ai vetë nuk është huamarrës. Projekti në fjalë nuk mund të zëvendësohet me projekte të tjera.

2. Në rast se qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau hua ose shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose shuma të tjera financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, atëherë gjen zbatimin kjo marrëveshje.

3. Shumat e financimit për masa përgatitore dhe shoqëruese sipas nenit 1 paragrafi 2 do të kthehen në hua, në rast se ato nuk përdoren për masa të tilla.

Neni 2

1. Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të përfundohen midis Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe marrësve të huave dhe të shumave të financimit, të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

2. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1 paragrafi 1 do të zhvleftësohet, në rast se kontratat përkatëse të huadhënies dhe të financimit nuk përfundohen brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premtimit. Për shumat e përmendura në nenin 1, ky afat mbaron në datën 31 dhjetor 2017.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është huamarrës, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau të gjitha pagesat në euro për shlyerjen e borxheve të huamarrësve në bazë të kontratave, të cilat do të përfundohen sipas paragrafit 1.

4. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është marrësi i shumave të financimit, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau pretendimet eventuale lidhur me shlyerjen, që mund të lindin në bazë të kontratave për financim, të cilit do të përfundohen sipas paragrafit 1.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e liron Kreditanstalt für Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratave të përmendura në nenin 2 paragrafi 1.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore që rezultojnë nga dhënia e huave dhe e shumave të financimit, nuk merr asnjë masë, e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe nxjerr në rastet e duhura lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, më 11.5.2011, në dy origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur të dyja tekstet fuqi të barabartë.

VENDIM
Nr.450, datë 22.6.2011

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË
GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR, 2008, 2010, PËR PROJEKTIN
“INFRASTRUKTURA KOMUNALE II”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2008, 2010, për projektin “Infrastruktura komunale II”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR 2008, 2010 PËR
PROJEKTIN “INFRASTRUKTURA KOMUNALE II”**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë,

në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë,

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë,

të ndërgjegjshëm se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje,

me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë,

duke iu referuar protokolleve të bisedimeve ndërqeveritare të datës 7 tetor 2008 dhe të datës 18 maj 2010,

u morën vesh si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose marrësve të tjerë, të cilët do të zgjidhen bashkërisht nga të dyja qeveritë, të marrin nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) shumat e mëposhtme për projektin “Infrastruktura komunale II”:

1) hua me vlerë gjithsej 1 000 000 euro (me fjalë: një milion euro) nga premtimi i vitit 2008;

2) hua me vlerë prej gjithsej 1 000 000 euro (me fjalë: një milion euro) nga premtimi i vitit 2010, kur nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t'u mbështetur.

2. Përveç kësaj, Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose një huamarrësi tjetër, i cili do të zgjidhet bashkërisht nga të dyja qeveritë, të marrë për projektin “Infrastruktura komunale II” një hua me kushte të favorshme nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW), e cila akordohet në kuadër të bashkëpunimit publik zhvillimor, me vleftë prej deri në 12 000 000 euro (me fjalë: dymbëdhjetë milionë euro) nga premtimi i vitit 2010,

kur nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t'u mbështetur në kuadër të politikës zhvillimore dhe kur Republika e Shqipërisë vazhdon të jetë e besueshme lidhur me kreditë dhe kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë jep garanci shtetërore, në rast se ai vetë nuk është huamarrës. Projekti në fjalë nuk mund të zëvendësohet me projekte të tjera.

3. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau hua ose shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose shuma të tjera financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, atëherë gjen zbatim kjo marrëveshje.

4. Shumat e financimit për masa përgatitore dhe shoqëruese sipas nenit 1 paragrafi 2, do të kthehen në hua, në rast se ato nuk përdoren për masa të tilla.

Neni 2

1. Përdorimi i shumave të përmendura në nenin 1, kushtet me të cilat vihen në dispozicion ato, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të përfundohen midis Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe marrësve të huave dhe të shumave të financimit, të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

2. Premtimi i shumave të përmendura në nenin 1 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 do të zhvleftësohet, në rast se kontratat përkatëse të huadhënies dhe të financimit nuk përfundohen brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premtimit. Për shumën e përmendur në nenin 1, paragrafi 1 pika 1, ky afat mbron në datën 31 dhjetor 2016. Për shumat e përmendura në nenin 1, paragrafi 1 pika 2 dhe nenin 1 paragrafi 2, ky afat mbaron në datën 31 dhjetor 2018.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është huamarrës, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau të gjitha pagesat në euro për shlyerjen e borxheve të huamarrësve në bazë të kontratave, të cilat do të përfundohen sipas paragrafit 1.

4. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është marrësi i shumave të financimit, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau pretendimet eventuale lidhur me shlyerjen, që mund të lindin në bazë të kontratave për financim, të cilat do të përfundohen sipas paragrafit 1.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e liron Kreditanstalt für Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratave të përmendura në nenin 2 paragrafi 1.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore që rezultojnë nga dhënia e huave dhe e shumave të financimit, nuk merr asnjë masë, e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe nxjerr në rastet e duhura lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, më 11.5.2011, në dy origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur të dyja tekstet fuqi të barabartë.

VENDIM
Nr.451, datë 22.6.2011

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË
GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR 2008, PËR PROJEKTIN
“MASTERPLANI NË SEKTORIN UJOR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2008, për projektin “Masterplani në sektorin uJOR”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE
**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR 2008 PËR
PROJEKTIN “MASTERPLAN NË SEKTORIN UJOR”**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë,

në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë:

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë,

të ndërgjegjshëm se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje,

me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë,

duke iu referuar protokolleve të bisedimeve ndërqeveritare të datës 7 tetor 2008 dhe të datës 18 maj 2010,

u morën vesh si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose marrësve të tjerë, të cilët do të zgjidhen bashkërisht nga të dyja qeveritë, të marrin nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) një shumë financimi prej gjithsej 2 000 000 euro (me fjalë: dy milionë euro) për projektin “Masterplan në sektorin uJOR” nga premtimi i vitit 2008, kur nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t'u mbështetur.

2. Po të merren vesh Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, projektet e përmendura në paragrafin 1 mund të zëvendësohen me projekte të tjera.

3. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau hua ose shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose shuma të tjera financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, atëherë gjen zbatimin kjo marrëveshje.

Neni 2

1. Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të përfundohen midis Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe marrësve të shumave të financimit, të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

2. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1 paragrafi 1 do të zhvleftësohet, në rast se kontratat përkatëse të financimit nuk përfundohen brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premtimit. Për shumën në fjalë, ky afat mbaron në datën 31 dhjetor 2016.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është marrësi i shumës së financimit do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau pretendimet eventuale lidhur me shlyerjen, që mund të lindin në bazë të kontratave për financim, të cilat do të përfundohen sipas paragrafit 1.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e liron Kreditanstalt für Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratave të përmendura në nenin 2 paragrafi 1.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore që rezultojnë nga dhënia e huave dhe e shumave të financimit, nuk merr asnjë masë, e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta, të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe nxjerr në rastet e duhura lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, më 27.4.2011, në dy origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur të dyja tekstet fuqi të barabartë.

VENDIM

Nr.454, datë 22.6.2011

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS PASKUQAN TË QARKUT TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Paskuqan të qarkut të Tiranës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të

komunës Paskuqan të qarkut të Tiranës, miratuar me vendimin nr.346, datë 20.5.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Paskuqan, të qarkut të Tiranës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Paskuqan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Paskuqan

Lidhje nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-7	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
8-11	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
12-162	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çfarëdo lloji	Në përdorim
163-165	Varreza publike	Në pronësi
186-188, 190-193, 195	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik (arë, pemëtore, vreshta, ullishte)	Në përdorim
189,194	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik (toka joproductive)	Në pronësi
197-276	Infrastrukturë rrugore	Në pronësi

VENDIM
Nr.456, datë 22.6.2011

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS ÇAKRAN TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Çakran të qarkut të Fierit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 50 (pesëdhjetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 295 (dyqind e nëntëdhjetë e pesë).

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Çakran për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-6	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile	Në pronësi
7,289-293	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
8-27	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
29-37/1	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
38-51	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
52-119	Varrezat publike	Në pronësi
153,158,163,167,173,178,181,182,186,188,189,196,201,204,212,215,216,219,221,222,224,226,230,235	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproductive)	Në pronësi
211,213,214,217,218,220,223,225,227-229,231-234,236	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
241-269,284-288	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
294-295	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim

VENDIM**Nr.457, datë 22.6.2011****PËR MIRATIMIN E DËMSPËRBLIMIT FINANCIAR PËR ISH-TË DËNUARIT POLITIKË TË REGJIMIT KOMUNIST**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9 e 10 të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e dëmshpërblimit financiar për ish-të dënuarit politikë dhe për familjarët e të dënuarve me dënim kapital, sipas listës së përfshirë në anekset “A”, “B” dhe “C”, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Masa e dëmshpërblimit për ish-të dënuarit politikë dhe familjarët e të dënuarve, me dënim kapital të bëhet me këste, sipas kriterëve e kufijve të përcaktuar në nenin 12 të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar.

3. Shuma e llogaritur transferohet në një llogari speciale në Bankën e Shqipërisë. Paga e dëmshpërblimit për secilin përfitues bëhet nga Ministria e Financave, në llogaritë personale të këtyre përfituesve, të hapura në bankat e nivelit të dytë, të përzgjedhura sipas nenit 33 të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007, të ndryshuar.

4. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI A

Lista nr. 20 e ish te denuarave te cilet kane vuajtur denim me burg

Nr.	N. Dostja	Data e dhjetes individuale	Emër	Mbiemër	Atësi	Amësi	Datëlindja	Vendlindja	Gjinia	Periudha e plore e vuajtjes se dënimit	Shuma e dënshpërblimit në lekë	Përfillimet nga ligje të mëparshme			Dëmshpërblimi përfundimtar
												Ministria e Financës	Enti Kombëtar i Banesave	Z.O.R.P.P	
												Lehtë	Vlerë	Zëfiri me	
1	986	15.02.2008	Aqif	Mahmuti	Daman	Gjybo	07.01.1949	Vlorë	M	4 vjet 8 muaj 16 ditë	3,448,000	0	566,466	0	2,881,534
2	1984	28.02.2008	Llak	Gjoni	Barjam	Sumbull	20.09.1922	Tepelenë	M	2vjet,6muaj,29ditë	1,890,000	100,000	140,000	0	1,650,000
3	1997	28.02.2008	Seqir	Shensiu	Sulejman	Rukajes	28.10.1909	Dibër	M	2vjet,6muaj,25ditë	1,510,000	0	248,380	0	1,225,620
4	2884	06.03.2008	Saiko	Brabo	Ali	Adilte	15.08.1920	Filat-Greqi	M	4vjet,8muaj,11ditë	3,438,000	200,000	463,560	0	2,774,440
5	3877	18.03.2008	Sul	Burgaj	Kurt	Zybe	13.02.1888	Koplik	M	5 v 10 m 23 d	4,316,000	100,000	1,000,000	0	3,216,000
6	4490	21.03.2008	Shefqet	Bacani	Bajram	Syme	15.06.1956	Dibër	M	2vjet,5muaj,12ditë	1,794,000	200,000	71,856	0	1,522,144
7	5305	03.04.2008	Islam	Skepi	Bajram	Fatime	03.11.1920	Billçe-Dibër	M	3 v	2,190,000	0	360,329	0	1,829,671
8	6559	04.04.2008	Maksut	Hoxha	Nexhip	Salo	20.03.1900	Gjrokaastër	M	15 vjet 1 muaj 22 ditë	11,056,000	150,000	1,500,000	0	9,406,000
9	6616	04.04.2008	Mhill	Arra	Nik	Lule	12.03.1901	Shkoder	M	1 vit 13 ditë	756,000	0	129,603	0	626,397
10	7130	10.04.2008	Miqo	Pilo	Kristo	Thedhora	19.08.1913	Sarandë	M	D1. 9 vjet 3 muaj 25 ditë D2. 4 vjet 3 muaj 3 ditë	9,918,000	0	0	0	9,918,000
11	7865	18.04.2008	Hashim	Oshafi	Hetem	Hava	01.02.1920	Blacë	M	8 vjet, 4 muaj, 27 ditë	5,584,000	30,000	1,006,356	0	4,547,644
12	7884	18.04.2008	Myrteza	Dapi	Kadri	Cac	11.02.1903	Tiranë	M	3 vjet 2 muaj 6 ditë	2,326,000	200,000	375,000	0	1,751,000
13	8192	22.04.2008	Seit	Brahmaj	Yezir	Hava	06.05.1915	Fier	M	7 vjet 30 ditë	5,170,000	0	850,621	0	4,319,379
14	8450	25.04.2008	Gjergj	Kolcici	Gjok	Ditë	25.09.1919	Leshë	M	D2. 8 vjet 8 muaj 23 ditë D3. 9 vjet 11 muaj 20 ditë	14,866,000	100,000	210,000	0	14,556,000
15	8894	05.05.2008	Hajri	Mahmutaj	Zilfo	Selvi	30.12.1910	Zhapokë	M	5 vjet, 3 muaj, 22 ditë	3,880,000	0	695,920	0	3,176,080
16	9498	13.05.2008	Halit	Xheliku	Xheladin	Hajrte	13.02.1913	Dibër	M	1 vit 3 muaj 24 ditë	964,000	0	50,000	0	914,000
17	9580	14.05.2008	Hysen	Nakaj	Ukë	Zoqë	30.01.1911	Humitë-Tropojë	M	10 vjet, 9 muaj 29 ditë	7,916,000	25,000	1,300,931	0	6,590,069
18	9635	15.05.2008	Izet	Brasaj	Reshat	Beje	01.06.1943	Skrapar	M	5 vjet 5 muaj 10ditë	3,980,000	0	650,000	0	3,330,000
19	9681	15.05.2008	Ismail	Aruçi	Demir	Deje	13.02.1914	Krujë	M	5 vjet 8 muaj 24 ditë	4,194,000	100,000	500,000	0	3,594,000
20	10064	22.05.2008	Ndue	Perfala	Preng	Mare	10.06.1927	Mirditë	M	10 vjet 4 muaj 9 ditë	7,006,000	188,110	2,344,055	0	4,473,835
21	11147	13.06.2008	Oqazim	Kryeziu	Bajram	Gjyle	03.07.1915	Kryezi. Puke	M	6 vjet, 10 muaj, 10 ditë	5,020,000	0	840,000	0	4,180,000
22	11295	17.06.2008	Dhimitër	Verdhi	Militiadh	Sevasti	03.04.1935	Gjrokaastër	M	8 vjet 11 muaj 13 ditë	6,548,000	100,000	1,043,006	0	5,404,994
23	11410	19.06.2008	Ali	Kaziu	Ismail	Naimë	10.11.1896	Mat	M	2 vjet	1,460,000	0	240,000	0	1,220,000
24	11514	24.06.2008	Myfit	Tarelli	Bektash	Sabire	23.05.1927	Korçë	M	20vjet,3muaj,13ditë	9,874,000	200,000	2,400,000	1,095,000	6,179,000
25	11520	24.06.2008	Tasim	Mata	Sefer	Xhevo	07.08.1926	Tepelenë	M	5 muaj 7 ditë	324,000	299,616	19,014	0	5,370
26	11649	25.06.2008	Nazmi	Çela	Halim	Nafije	06.09.1912	Burrël	M	4 vjet, 10 muaj, 30 ditë	3,600,000	0	1,734,575	1,527,399	338,026
27	11997	07.07.2008	Hasan	Gashi	Imcr	Meslime	09.07.1936	Kukës	M	3 vjet,11 muaj,30 ditë	2,920,000	0	0	0	2,920,000
28	12181	10.07.2008	Sabri	Mullaj	Hysni	Saile	07.06.1902	Korcc	M	8 vjet 9 muaj 20 ditë	6,438,000	200,000	1,030,000	0	5,188,000
29	12190	10.07.2008	Mustafa	Zigjina	Nuredin	Xhemile	15.01.1911	Lushnjë	M	3vjet,4muaj,10ditë	2,438,000	0	498,393	0	1,939,607
30	12228	11.07.2008	Hidër	Bohari	Elez	Hasime	20.03.1909	Peshkopi	M	2vjet,9muaj,28ditë	2,074,000	0	0	0	2,074,000
31	12285	14.07.2008	Yzedin	Hysenaj	Qemal	Beke	31.12.1931	Vlore	M	3 vjet 7 muaj 2ditë	2,056,000	0	0	0	2,056,000
32	12413	18.07.2008	Murat	Mustafa	Qamil	Elma	09.03.1887	Perncet	M	3 vjet 8 muaj 30 ditë	2,746,000	0	480,329	0	2,265,671
33	12649	25.07.2008	Pal	Bunaj	Mark	Marë	18.11.1928	Mirditë	M	1 vit, 1 muaj, 2 ditë	796,000	200,000	30,849	0	565,151
34	12774	30.07.2008	Hazis	Cara	Mustafa	Meleke	05.03.1897	Elbasan	M	1vit,11muaj,8ditë	1,428,000	0	240,000	0	1,188,000

35	13290	22.08.2008	Sokrat	Duni	Mantho	Fotinë	29.05.1923	Vlorë	M	3 vjet, 7 muaj, 27 ditë	2.678.000	0	439.233	0	0	0	2.238,767
36	13424	29.08.2008	Kolë	Shyqypasa	Tahir	Lulë	13.06.1921	Shkodër	M	4 vjet, 8 muaj, 27 ditë	3.470.000	150.000	467.829	0	0	0	2.852,171
37	14232	02.10.2008	Kolë	Malocaj	Zef	Marë	17.07.1908	Shkodër	M	D1. 4 vjet, 3 muaj, D2. 7 vjet, 9 muaj, 23 ditë	7.106.000	0	140.000	0	0	0	6.966,000
38	14659	22.10.2008	Panajot	Fidhi	Thoma	Maria	10.03.1904	Gjrokastrë	M	7 vjet 8 muaj 20 ditë	5.646.000	100.000	817.918	0	0	0	4.728,082
39	14668	22.10.2008	Selami	Xhudo	Nasuf	Hava	10.12.1915	Pogradec	M	11 vjet 11 muaj 24 ditë	8.760.000	0	1.835.445	1.295.000	0	0	5.629,555
40	14730	23.10.2008	Ibrahim	Cara	Latif	Hane	15.07.1944	Durrës	M	3 vjet 9 muaj 29 ditë	2.806.000	0	459.025	0	0	0	2.346,975
41	15246	12.11.2008	Bashkim	Dinaku	Rustem	Firdes	10.05.1958	Shkodër	M	5 vjet, 9 muaj, 21 ditë	4.250.000	0	697.295	0	0	0	3.552,705
42	15538	26.11.2008	Adem	Musaraj	Jonus	Merjeme	05.04.1940	Kurë Fier	M	6 vjet 6 muaj 9 ditë	4.770.000	0	783.123	0	0	0	3.986,877
43	16039	05.12.2008	Nusret	Cela	Irfan	Fatime	16.01.1959	Tiranë	M	6 vjet, 7 muaj, 19 ditë	3.034.000	0	800.000	0	0	0	2.234,000
44	16147	09.02.2008	Llesh	Gjerci	Ndue	Preng	07.08.1890	Mirditë	M	5 vjet 8 muaj 5 ditë	3.232.000	0	682.521	0	0	0	2.549,479
45	16163	09.12.2008	Arnstiel	Ksера	Jani	Melpomeni	15.08.1953	Gjrokastrë	M	4 vjet, 0 muaj, 19 ditë	2.958.000	0	485.274	0	0	0	2.472,726
46	16268	11.12.2008	Pilo	Kosta	Tolo	Argjuro	23.04.1923	Gjrokastrë	M	6 vjet 2 muaj 8 ditë	4.520.000	0	749.403	0	0	0	3.770,597
47	16324	11.12.2008	Egerem	Musta	Hasan	Dije	18.12.1926	Durrës	M	1 vite 4 muaj 6 ditë	990.000	100.000	53.600	0	0	0	836,400
48	16346	11.12.2008	Zyhdi	Haxhiatushi	Riza	Nadire	02.03.1903	Kavajë	M	7 vjet 10 muaj 20 ditë	5.770.000	0	950.137	0	0	0	4.819,863
49	16381	12.12.2008	Ilirjan	Cela	Elez	Agustella	16.04.1961	Shkodër	M	0 vjet, 4 muaj, 13 ditë	274.000	0	44.296	0	0	0	229,704
50	16475	15.12.2008	Dod	Luka	Luk	Dilë	03.02.1888	Lezhë	M	4 vjet 10 muaj 0 ditë	3.540.000	0	579.779	0	0	0	2.960,221
51	16555	16.12.2008	Agjin	Qejvanaj	Pellumb	Pashako	04.12.1951	Durrës	M	5 vjet 9 muaj 21 ditë	3.918.000	0	700.000	0	0	9,800	3.208,200
52	16823	19.12.2008	Ymer	Maliko	Ismail	Elmazie	04.06.1933	Koskë, Fier	M	4 vjet, 26 ditë	2.972.000	0	500.000	0	0	0	2.472,000
53	16981	19.12.2008	Myrfit	Malaj	Hysni	Refo	18.04.1927	Raninë	M	18 vjet, 9 muaj, 16 ditë	13.730.000	0	2.280.000	0	0	0	11.450,000
54	16982	19.12.2008	Egerem	Malaj	Hysen	Refo	31.12.1936	Vlorë	M	3 vjet, 7 muaj, 5 ditë	1.610.000	100.000	540.000	0	0	0	970,000
55	17049	26.12.2008	Shefqet	Gegolli	Mustafa	Hedije	04.06.1917	Devoll	M	8 vjet 2 muaj 10 ditë	5.984.000	100.000	880.796	0	0	0	5.003,204
56	17533	19.12.2008	Frok	Gjoka	Pjeter	Mare	18.04.1921	Mirditë	M	5 vjet	3.650.000	200.000	500.329	0	0	0	2.949,671
57	17738	08.05.2009	Preng	Coku	Jak	Gjelë	15.07.1923	Shkodër	M	2 vjet, 5 muaj, 6 ditë	1.782.000	98.000	29.169	0	0	0	1.654,831
58	17758	08.05.2009	Rexhep	Baqnozi	Jashar	Hamide	16.12.1900	Butas, Fier	M	6 vjet, 4 muaj, 8 ditë	4.644.000	0	840.000	0	0	0	3.804,000
59	18093	08.05.2009	Hasan	Sina	Osman	Leme	10.04.1897	Lushnje	M	1 vit	732.000	0	120.000	0	0	0	612,000
60	18124	08.05.2009	Bardhyl	Çitozi	Muharrem	Mereme	11.03.1957	Krujë	M	11 vjet 18 ditë	6.856.000	0	1.377.600	0	0	0	5.478,400
61	18727	08.05.2009	Sejdi	Gjeçka	Metë	Sane	15.02.1933	Gjrokastrë	M	5 vjet, 0 muaj, 27 ditë	3.704.000	60.000	60.000	0	0	0	3.584,000
62	18761	08.05.2009	Dilaver	Premtaj	Rapo	Nasibe	30.01.1928	Vlorë	M	D1. 2 vjet, 0 muaj, 1 ditë D2. 14 vjet, 0 muaj, 1 ditë	11.684.000	200.000	1.718.529	1.583.400	0	0	8.182,071
63	18957	08.05.2009	Mehmet	Can	Hasan	Zonjë	10.04.1903	Terrave	M	6 v 7 m 2 d	4.818.000	0	786.479	0	0	0	4.031,521
64	19088	08.05.2009	Mark	Lkeshi	Llesh	Prendë	14.09.1908	Pukë	M	5 vjet	3.650.000	0	599.128	0	0	0	3.050,872
65	19104	08.05.2009	Sipri	Gjerdede	Petro	Ollge	14.09.1935	Vuno, Vlorë	M	4202 ditë	8.404.000	150.000	1.197.600	0	0	0	7.056,400
66	19361	08.05.2009	Refat	Mimo	Braho	Haitxhe	01.01.1928	Kolonjë	M	1 vit, 8 muaj, 26 ditë	1.278.000	100.000	111.068	0	0	0	1.066,932
67	19664	26.05.2009	Ndre	Lufi	Gaspër	Nine	30.11.1887	Shkodër	M	9 vjet, 8 muaj, 3 ditë	7.072.000	0	1.598.068	0	0	0	5.473,932
68	19687	26.05.2009	Krenar	Ymeraj	Nexhat	Tagjibe	27.08.1950	Tiranë	M	12 vjet, 10 muaj, 27 ditë	2.696.000	0	1.150.685	0	0	0	1.545,315
69	19766	29.05.2009	Skender	Dume	Hasan	Atxhe	14.06.1912	Kolonjë	M	4 vjet 11 muaj 6 ditë	3.614.000	200.000	502.301	0	0	0	2.911,699
70	20256	19.06.2009	Ijjaz	Korça	Ali	Naime	12.05.1906	Korçë	M	15 vjet 2 muaj 5 ditë	11.084.000	0	1.867.897	0	0	0	9.216,103
71	20461	24.06.2009	Ndue	Mela	Pal	Blut	12.08.1915	Shkodër	M	1 vit, 1 muaj, 6 ditë	804.000	100.000	480.000	0	0	0	224,000
72	20762	29.06.2009	Murat	Barolli	Idris	Beqzade	05.08.1895	Korçë	M	5 vjet	3.650.000	100.000	600.329	0	0	0	2.949,671

73	20858	30.06.2009	Zija	Pershaku	Zenel	Dane	23.11.1913	Kercisht	M	10 vjet 5 muaj 17 ditë	7,644,000	0	1,254,375	0	0	6,389,625
74	20883	30.06.2009	Maliq	Saltiani	Mehmet	Keze	31.12.1882	Korce	M	8 vjet	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
75	20916	30.06.2009	Foto	Duni	Llambro	Marë	26.02.1910	Vlore	M	8 vjet, 8 muaj, 24 ditë	6,384,000	200,000	949,096	0	0	5,234,904
76	21087	01.07.2009	Qafisere	Reka	Hysni	Kume	02.01.1926	Tirane	F	D1. 5 vjet 1 muaj D2. 6 muaj 23 ditë	4,130,000	200,000	410,521	0	0	3,519,479
77	7130/A	10.04.2008	Angjeliq	Sterjopullo	Jani	Galla	26.04.1926	Saranë	F	4 vjet 10 muaj 15 ditë	3,570,000	100,000	486,000	0	0	2,984,000
279,962,584																

ANEKSI B

Lista nr. 20 e ish të dënuarve, të cilët janë dënuar me dënim kapital

Nr.	Nr. Dosjes	Data e dosjes individuale	Emër	Mbledhës	Atësi	Amësi	Datëlindja	Vendlindja	Gjinia	Viti i vdekjes	Shuma e dëmshpërblimit në lekë	Përfillimet nga ligje të mëparshme			Dëmshpërblimi përfundimtar	
												Ministria e Financës	Enti Kombëtar i Banesave	Z.Q.R.P.P		
												Letra me Vlerë				
1	2384	04.03.2008	Refat	Mazelliu	Mehmet	Vaidë	15.06.1888	Korçë	M	13.12.1945	5,840,000	200,000	179,640	0	0	5,460,360
2	2833	06.03.2008	Sejdi	Hyskaj	Muhamrem	Xhane	10868	Vlorë	M	13.09.1955	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
3	9655	15.05.2008	Gjon	Sina	Mark	Dile	1908	Shkoder	M	28.02.1945	5,840,000	200,000	0	0	5,640,000	
4	10177	26.05.2008	Pal	Qafa	Preng	Dile	17.02.1937	Pukë	M	28.02.1977	5,840,000	400,000	720,000	570,000	0	4,150,000
5	10507	30.05.2008	Dul	Muca	Bajram	Syke	65 vjeç	Vukpalaj	M	25.03.1945	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
6	18670	08.05.2009	Shaban	Hoxhaj	Musli	Rushë	10.03.1903	Luzhë	M	20.03.1946	5,840,000	200,000	100,000	0	0	5,540,000
7	19463	08.05.2009	Zalo	Xhornaci	Vait	Makë	13.12.1921	Bejkovë	M	17.06.1947	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
8	19720	27.05.2009	Aqif	Kashah	Riko	Hutixhe	23.02.1910	Gjrokaster	M	01.03.1948	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
9	20975	01.07.2009	Aqif	Haveniku	Mehmet	Sanije	05.04.1910	Kavajë	M	11.06.1947	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000

40,470,360

• ANEKSI C

Lista nr. 20 e ish te denuareve te cilet kane vleren 0

Nr.	Nr. Dosjes	Data e cmosjes individuale	Emër	Mbiemër	Atësi	Amesi	Datëlindja	Vendlindja	Gjinia	Përiudha e plotë e vuajtjes së dënimit	Shuma e dëmshpërblimit në lekë	Përfundimet nga ligje të mëparshme				Dëmshpërblimi përfundimtar
												Ministria e Finacës	Enti Kombëtar i Banesave	Letra me Vlerë	Z.Q.R.P.P	
1	13881	18.09.2008	Daut	Sulejmani	Ismail	Melha	10.10.1883	Sarandë	M	2 vjet, 14 ditë	1,488,000	0	239,192	2,906,308	0	0

VENDIM
Nr.458, datë 22.6.2011

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË TURIZMIT,
KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE TË PRONËS NR.276 “CIRKU I TIRANËS” NË
JURIDIKSION TË BASHKISË SË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 10, 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të nenit 8/a të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit njësite të qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të neneve 5 e 6 të ligjit nr.10 352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të pronës së paluajtshme shtetërore “Cirku i Tiranës”, me numër rendor 276 (nr.pasurie 6/227), në listën që i bashkëlidhet vendimit nr.834, datë 13.12.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së pjeshme të inventarit (pjesa e parë + pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme shtetërore, në Bashkinë Tiranë të qarkut të Tiranës”.

2. Ngarkohen Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.14, datë 16.6.2011

**PËR PAGESËN E DETYRIMEVE NDAJ TË TRETËVE TË NDËRMARRJEVE DHE SHA-VE
NË PRONËSI TË PUSHTETIT VENDOR**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 4 të ligjit nr.10 340, datë 28.10.2010 “Për pagesën e detyrimeve ndaj të tretëve të ndërmarrjeve dhe sh.a.-ve, në pronësi të pushtetit vendor”, Ministri i Financave, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

UDHËZOJNË:

1. Në rastet kur ndërmarrjet publike dhe/ose sh.a.-të, në pronësi të pushtetit vendor, nuk paguajnë në kohë detyrimet e tyre ndaj të tretëve, njësitë e qeverisjes vendore janë përgjegjëse për pagimin e tyre.

2. Për rastet kur ndërmarrjet dhe/ose sh.a.-të subvencionohen nga pushteti qendror dhe/ose vendor, Ministri i Financave, nëpërmjet degëve të thesarit në rrethe, verifikon arsyet e mospagesës së detyrimit ndaj të tretëve vetëm për çështjet që lidhen me interesat jetikë dhe bazë të komunitetit (furnizimin me ujë të pijshëm), pastrimin e mbeturinave, kanalizimet etj.).

3. Pas kryerjes së verifikimit të mësipërm, Ministri i Financave, me anë të një shkrese, i kërkon njësisë së qeverisjes vendore, marrjen e masave për zgjidhjen e problematikës së krijuar me ndërmarrjen publike dhe/ose sh.a.-të, në pronësi të saj, duke e vënë në dijeni të sanksioneve ligjore të cilave do t'u nënshtrohet në rast të moszgjidhjes së problemit.

4. Njësia e qeverisjes vendore, me marrjen e shkresës, është e detyruar që brenda një afati kohor prej 30 ditësh, të marrë masa për zgjidhjen e problemit, si dhe të raportojë pranë Ministrit të Financave, në lidhje me masat dhe afatin kohor të zgjidhjes së problemit.

5. Në rastin kur njësia e qeverisjes vendore nuk respekton afatin kohor të raportimit të kërkuar në pikën 4 të këtij udhëzimi, si dhe në rastin kur ajo (NJQV) nuk e zgjidh problemin brenda afatit kohor të deklaruar, Ministri i Financave, me anë të një shkrese të përbashkët të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit dhe të Thesarit, urdhëron degën e thesarit, në juridiksionin e së cilës ndodhet njësia e qeverisjes vendore, të bllokojë të gjitha veprimet financiare të saj, me përjashtim të veprimeve që kanë të bëjnë me pagesën e shpenzimeve të personelit, si dhe ato për ushqimin dhe ngrohjen në kopshte, çerdhe, qendra sociale dhe shkolla.

6. Me kryerjen e bllokimit të fondeve, përgjegjësi i degës së thesarit, me anë të një shkrese, duhet të njoftojë menjëherë Ministrin e Financave. Njësia e qeverisjes vendore do të qëndrojë e bllokuar deri në momentin e paraqitjes së urdhërpagesës së likuidimit të detyrimit, apo të një kontrate/marrëveshje të shlyerjes së detyrimit me këste, të firmosur nga kryetari i njësisë dhe autoriteti përgjegjës i institucionit ndaj të cilit ka lindur detyrimi.

7. Në momentin e paraqitjes së urdhërpagesës apo kontratës, përgjegjësi i degës së thesarit njofton Ministrinë e Financave dhe kryen zhbllokimin e fondeve. Në rast të dorëzimit të një kontrate për shlyerje me këste të detyrimit, dega e thesarit kryen kontrollin/ndjekjen e likuidimit të këtyre kësteve.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE
DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

MINISTRI I EKONOMISË,
TREGTISË DHE ENERGETIKËS
Nasip Naço

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 15.7.2011
Doli nga shtypi më 17.7.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 24 lekë